

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 30.01.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Mungoi: Goran Marinković

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i Rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18.01.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit të Policisë lidhur me protestat e datës 14.01.2012;
4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
5. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për projektligjin nr. 04/L-89 për dominim humanitar;
6. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të Ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës, i cili u miratua pa ndryshime. Gjithashtu njoftoi se në pikën të ndryshme, do të jete prezantimi i një Organizate “IRID” e cila do të shpalos idetë, qëllimet dhe synimet e tyre për një projekt që kanë.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18.01.2012

Kryetari i Komisioni- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.01.2012 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Policisë lidhur me protestat e datës 14.01.2012

Kryetari i Komisionit- Shqyrtimi i Raportit të Policisë lidhur me protestat e datës 14.01.2012, Kryetari shtoi që ky Raport ka ardhur ne afatin kohorë dhe deklaroi që ky takim është i hapur për Media, çdo vërejtje që do të bëhet për Raportin e Policisë është e bërë nga Komisioni, këto vërejtje dhe sugjerime do të jenë si përmbledhje.

Raporti përshinë elemente që e përcjellin angazhimin e Policisë së Kosovës në ngjarjet e 14 janarit 2012, me ndonjë defekt i cili gjatë diskutimit do të merret parasysh, fjalën ua kaloj anëtarëve të Komisionit.

Rexhep Selimi- Raporti nga Policia e Kosovës për ngjarjet e 14 janarit, ka ardhur në datën e kërkuar nga Komisioni për analizim. Sa i përket Raportit, mendoj që është bërë një vlerësim politik dhe jo profesional për ngjarjet e 14 janarit 2012 dhe ka tendencën e zhvendosjes së përgjegjësisë së menaxhmentit të Policisë tek Policia, individë të caktuar. Përgjegjësia nuk mund të bie tek Policët të cilët e kanë zbatuar urdhrin por mbi hartuesit e këtij operacionit dhe urdhrave operativ sidomos në pikën kufitare në Merdare por edhe në një masë të caktuar edhe në Dheun e Bardhë.

Raporti e pranon që është zbatuar urdhri me përpikëri, por na bënë të kuptojmë që operacioni paska qenë i para përgatitur që të jetë i dhunshëm. Raportit të bërë nga Policia nuk i takon të bëjë vlerësimin për situatën apo për subjektet pjesëmarrës, ashtu siç përmendet në raport për Lëvizjen Vetëvendosje si organizuese e protestës, ku thuhet që qëllimi i këtij subjekti ka qenë bllokimi i dy pikave kufitare, gjë që nuk është e vërtetë.

Nga takimi që kemi pasur me Policinë, Mediat dhe nga ajo që ka rrjedhur me vonë, është parë që qëllimi i Lëvizjes Vetëvendosje nuk ka qenë bllokimi i pikave kufitare por ka pasur qëllim bllokimin e mallrave dhe dokumenteve të Serbisë për në Kosovë. Nuk i takon një Raporti Policor që të bëjë vlerësime politike.

Raporti i referohet informacioneve të medias për protestën, dhe nuk është përmendur që takimi i delegacionit të Vetëvendosjes me organet udhëheqëse të Policisë së Kosovës me udhëheqësin e Shtyllës së Operacioneve, pra ka pasur komunikim zyrtar me Policinë. Nuk ka pasur paralajmërim paraprak sipas ligjit për tubimet publike pasi Vendimi i Kuvendit për Mocionin ka qenë drita e gjelbër për të reaguar.

Raporti gjithashtu anashkalon arsyen bazë për të cilën është organizuar protesta, është dashur të shpalosen argumentet për këtë protestë. Nuk është përmendur as vendimi i Kuvendit i datës 7 dhjetor për Reciprocitetin dhe ky term nuk përmendet askund në Raport.

Raporti i referohet Ligjit për tubime publike, neni 7 paragrafi 4, ku thuhet ndalohet mbajtja e tubimeve publike në udhëkryqe dhe magjistrale për të mos penguar qarkullimin. Një rregull i tillë do të duhej të zbatohet edhe në Veri të Kosovës pasi atje janë të bllokuar lokacionet që ndalohen me ligjin për tubimet publike, duke e ditur që Policia e Kosovës ka kapacitete për të hapur magjistralet në veri.

Me fillimin e implementimit të operacionit policor në dy lokacionet, të gjithë pjesëtarët e njësive vartëse kanë qenë në nivelin e kryerjes së detyrës policore. Ky vlerësim paragjykon hetimet që janë ngritur për rastet e ashtuquajtura tejkalimit të kompetencave të policisë, vlerësime të bërë për këto tejkalime nga institucione kompetente për këtë gjë si Inspektorati Policor, Standardet e brendshme profesionale të Policisë të cilat kanë nisur disa hetime.

Vlerësim tjetër që ka të bëjë me pikën në afërsi të pikës kufitare në Merdare, kur thuhet që ashtu siç ishte paralajmëruar protestuesit e Lëvizjes Vetëvendosje dhe disa qytetar, referimi me terma të tillë si “disa” nuk është profesional dhe i saktë. Thuhet që protestuesit në ora 12:30 filluan të tubohen në grupe dhe më pas kanë bllokuar rrugën. Një konstatim i tillë nuk qëndron, pasi bllokimi i rrugës është bërë nga Policia.

Thuhet që protestuesit në vazhdimësi janë urdhëruar që të largohen nga rruga, por në fakt i është dhënë afati prej 5 minutash i cili nuk është në përputhje me manualin e nxjerrë nga Policia e Kosovës për menaxhimin e turmave. Në Raport thuhet që pas bllokimit të rrugëve, protestuesit kanë filluar të bëhen të dhunshëm, gjë që nuk është e vërtetë, megjithëse ndonjë reagim i protestuesve ka qenë i mundur.

Një pasaktësi tjetër e këtij Raporti ka të bëjë me evidencat e përfshira në Raport. Raporti thotë që, gjatë këtij intervenimi janë lënduar 29 zyrtar policor. Këto të dhëna duhet të bazohen në Raporte mjekësore ku ata janë drejtuar. Ky numër nuk ka të bëjë fare me realitetin. Ndërsa, kur i referohet protestuesve, thotë që janë lënduar disa pjesëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, kjo nuk është reale kur dihet që numri i protestuesve që kanë kërkuar ndihmë mjekësore ka qenë 30, këtë e dëshmojnë raportet mjekësore. Janë arrestuar 17 persona, pas konsultimit me Prokurorinë 15 prej tyre janë dërguar në mbajtje, edhe këto të dhëna janë relative.

Kur bëhet vlerësimi i situatës në pikën kufitare tek Dheu i Bardhë thuhet që janë lënduar 3 zyrtar Policor, as kjo e dhënë nuk qëndron. Ndërsa thuhet që janë lënduar 2 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje. Lëndimet e aktivistëve të Vetëvendosjes janë marrë gjatë arrestimit, përfshirë Nënkryetarin e Kuvendit, Deputetët edhe pse kanë qenë të gatshëm të bashkëpunojnë me policinë.

Raporti bënë analizën e shkurtër e veprimeve ku thotë, të gjithë pjesëtarët e njësive vartëse kanë qenë në nivelin profesional të kryerjes së detyrave policore.

Nëse detyrë policore ka qenë kjo që kemi parë, dhe kanë qenë në nivel të detyrës, nuk përbën funksionin e vetë policisë, pasi Policia zbatoi urdhrin e dhënë nga lartë. Ka tendencë për ta zhvendosur përgjegjësinë e menaxhmentit të Policisë tek zyrtarët policor. Për vlerësimin e punës së Policisë bëhet nga institucione kompetente për këtë, si Inspektorati Policor, Njësia për standarde profesionale në kuadër të Policisë së Kosovës.

Vlerësimi i performancës në Raport është pozitiv dhe thuhet që ka qenë adekuate, por në fakt një vlerësim i tillë nuk është bërë nga institucione Këshilli për mbrojtjen e të Drejtave të njeriut,

Avokati i Popullit dhe Amnesty International, të cilat kanë dalë me deklaratat e tyre se ka pasur tejkalim të kompetencash nga Policia ndaj protestuesve.

Sipas Raportit, operacioni është mbikëqyrur edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë nga EULEX-i, është mirë të dihet dhe sqarohet roli i këtyre mekanizmave mbikëqyrës gjatë protestës.

Fatmir Xhelili- Bazuar në Rendin e Ditës, ne duhet të bëjmë analizën e këtij Raporti por jo vlerësimin e situatës së 14 janarit 2012, pasi është e pa drejtë nëse vlerësojmë këto ngjarje pa pasur një bazë reale të vlerësimit nga ana e ekipeve profesionale të cilat janë marrë me monitorimin atë ditë.

Raporti i Policisë për ngjarjet e 14 janarit 2012, vë në pah të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në mënyrë kronologjike duke përcaktuar edhe dinamikën e zhvillimeve dhe përgatitjen e Policisë dhe njësive Policore për operacionin e zhvilluar deri tek veprimet e marra për menaxhimin e turmave. Policia këtë veprimtari e ushtron bazuar në parimet dhe në procedurat dhe autorizimeve që rrjedhin nga Ligji për Policinë e Kosovës por edhe nga procedurat mbi metodologjinë e punës së Policisë për menaxhimin e turmave.

Mekanizmi i Policisë dhe njësitë mbështetëse, bazuar dhe në Raportin e paraqitur për ngjarjet e 14 janarit, kanë kryer detyrën konform ligjit dhe autorizimeve që kanë pasur me objektiv të caktuar që kanë pasur ç'bllokimin e rrugëve magjistrale dhe pajtohem që Policia ka qenë në nivel gjatë kryerjes së detyrave, kanë zbatuar ligjin dhe përdorimi i forcës ka qenë aq sa është e nevojshme për menaxhimin e turmave, me përjashtim të ndonjë rasti që mund të jetë tejkaluar kjo forcë. Raporti do duhej të përfshinte numrin e saktë të Policëve dhe të protestuesve të lënduar.

Raporti në masë të madhe i përmbush të gjitha shpjegimet e kërkuara nga Komisioni, ndërkaq për vlerësimet e punës së Policisë të 14 janarit 2012, janë mekanizma të tjerë që bëjnë këtë vlerësim si Agjensioni i Inspektoratit Policor i cili i ka mundësitë të bëjë vlerësimin real të metodologjisë së përdorur nga Policia dhe është i autorizuar të përcaktoj tejkalimet eventuale në raste të tilla. Komponenta e Policisë së EULEX-it si mekanizëm vëzhgues gjithashtu bënë vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga Policia, vlerësimi nga ky komponent është shumë domethënës.

Të gjitha këto që përfshihen në Raport qëndrojnë, por do të ishte më mirë të ishte më i gjerë dhe më i drejtpërdrejtë në disa raste. Ky Raport është i Policisë dhe ne si Komision e vlerësojmë Raportin e jo situatën e zhvilluar. Në momentin kur do ta kemi Raportin nga Inspektorati Policor i Kosovës, atëherë do të kemi një pasqyrë të qartë për zhvillimet e datës 14 janar 2012.

Anton Quni- Sado që Raporti është gjithëpërfshirës ka disa mangësi për të dhënat empirike dhe statistikore, situata të ndryshme. Përveç numrit të Policëve të lënduar që është paraqitur në Raport, është dashur që të jetë edhe numri i protestuesve të lënduar, kalimtarëve të rastit.

Në Raport nuk është përfshirë ndërhyrja e njësive policore në prona private, nuk figuron asnjë rast që tregon që është nën hetim për rastet që janë konsideruar tejkalim i autorizimeve, nuk përmendet se a janë ngritur procedura hetimore ndaj disa pjesëtarëve policor, për të cilët është dokumentuar nga mediat se në disa raste ka pasur tejkalim të kompetencave.

Në Raport nuk është paraqitur rastet e performancës së Policisë ndaj deputetëve të Parlamentit të Kosovës, gazetarëve të moshuarve invalidëve etj. Nuk janë teknika të njëjta të arrestimit për të gjitha këto kategori.

Në rastet e përballjes së Policisë me turmat, është detyrë e Policisë që të identifikoj sfidat në këto raste të nxjerr mësimet dhe të rris nivelin e performancës për Policinë e Kosovës në rastet e situatave të ngjashme.

Rexhep Selimi- Raporti ka bërë vlerësim politik, dhe analiza e tij nuk ka se si të jetë ndryshe. Raporti nuk mbetet brenda kornizave institucionale. Sa i përket numrit të lënduarve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje që nuk është përfshirë në Raport, nëse kjo e dhënë i intereson Komisionit, mund të sillen me shkrimë, sa të lënduar janë bazuar në Raportet mjekësore dhe kjo në shërbim të Komisionit.

Kur thuhet në Raport për numrin e Policëve të lënduar 29, një raportim është i pa bazuar pasi nuk ka asnjë raport mjekësor për lëndimet e marra. Numri i zyrtarëve Policor të lënduar është 2 dhe kjo referuar në fakte. Por te thuhet që numri i aktivistëve të lënduar është disa, kjo është nënçmuese pasi Policia duhet ta dijë numrin e saktë.

Në Raportin e Policisë për ngjarjet e 25 korrikut 2011 të zhvilluara në veri të Kosovës, për numrin e policëve të lënduara thekson që është disa, e njëjta e dhënë përdoret edhe për ngjarjet e 14 janarit 2012 kur thuhet që numri i protestuesve të lënduar është disa. Kjo formë e raportimit nuk është e saktë dhe reale.

Vjollca Krasniqi- Duke vlerësuar raportin nuk mund ti shmangemi vlerësimit të situatës së 14 janarit. Raporti i Policisë nuk mund të jetë vetëkritik. Për ngjarjen e 14 janarit kemi të dhëna dhe të thëna të ndryshme nga Policia dhe nga Lëvizja Vetëvendosje, por ne priremi ti besojmë versionit zyrtar të Policisë së Kosovës.

Në Raport do të duhej të përfshihej edhe informacioni për arrestimin e deputetëve të Parlamentit të Kosovës, Nënkyetarit të Parlamentit. Raporti është dokument zyrtar dhe në të do të mbetet ky informacion për datën e arrestimit dhe datën e lirimit të këtyre zyrtarëve të lartë. Kjo protestë ka mundur të menaxhohet më mirë.

Fatmir Xhelili- Vlerësimi për performancën e Policisë do duhej të bëhej mbi bazën e informatave inteligjente e jo mbi baza emocionale. Të gjitha veprimet e ndërmarra nga menaxhuesit e operacioneve i kanë marrë bazuar në informacione inteligjente dhe kanë marrë hapat adekuat. Konstatimi se protestuesve u është kërkuar 5 minuta të largoheshin, ky nuk është konstatim i raportit, pasi urdhri për shpërndarje është dhënë disa herë.

Sa i përket numrit të Policëve të lënduar në protestën e 14 janarit, Policia e Kosovës e ka shërbimin shëndetësor në kuadër të Policisë së Kosovës, prandaj numri 29 për Policë të lënduar qëndron, por do të duhej që në raport të përfshihej edhe numri i protestuesve të lënduar dhe natyra e lëndimeve.

Ganimete Musliu- Tërheqja e një paraleleje me Raportin për ngjarjet e 25 korrikut 2011 me Raportin e 14 janarit 2012 nuk i bën nder askujt dhe se këtë nuk do ta dëshironin as protestuesit. Në raport është dashur të përfshihen edhe të dhënat për arrestimin e deputetëve dhe nënkryetarit të Kuvendit ndërsa për numrin 29 të Policëve të lënduar ky numër qëndron pasi për çdo dyshim mund të kërkojmë informacione shtesë, pasi nëse kemi dyshime për këtë Raport nuk do të kishte vlerë analiza. Sa i përket numrit të të lënduarve nga ana e protestuesve edhe tek jo jepen të dhëna që dallojnë me ato të dhëna nga Policia dhe ato që paraqiten nga Lëvizja Vetëvendosje.

Rexhep Selimi- Numri i Policëve të lënduar të paraqitur në raport nuk qëndron dhe nuk është i saktë, ndërsa sa i përket paraleles së ngritur për raportin e 14 janarit 2012 me atë të 25 korrikut 2012, një paralele e tillë mund të bëhet pasi ka trajtim të ndryshëm të dhënies së informacioneve

për këto situata dhe se ne në këtë raport nuk po e gjemë saktësinë që i nevojitet Komisionit për Siguri.

Fatmir Xhelili- Më mirë është të bëhet krahasimi mes protestës 14 janar 2012 dhe 22 janar 2012 ku tek protestat e dytë nuk pati asnjë mosmarrëveshje mes protestuesve dhe Policisë, kjo si rezultat i mos reagimit agresiv nga ana e protestuesve, ndërsa në Veri Policia ka reaguar me të gjitha potencialet që ka dhe dihet që Veriu menaxhohet me partneritet ndërkombëtar që janë kompetente për sigurinë, Bashkimin Evropian dhe Shtetet e bashkuara të Amerikës.

Rexhep Selimi- Cilësimi i protestës si agresive është vlerësim që i bëhet situatës nga ju z.Xhelili, prandaj mund të themi që protestat nuk ishin të dhunshme, ajo e 14 janarit 2012 eskaloj pasi Policia ishte e dhunshme ndërsa në 22 janar 2012 Policia ishte jo e dhunshme. Vlerësim i një Subjekti nga ana e Policisë nuk është në kompetencë të Policisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Ne konsiderojmë që protesta e 14 janarit ka pasur dhunë që kanë krijuar një imazh të keq për Kosovën,, ndërsa në protestën e 22 janarit ishte një kujdes i shtuar dhe kaloi në mënyrë të qetë. Ky duhet të jetë mësimi që duhet të nxjerrim që Institucionet të kryejnë obligimet ndaj qytetarëve të Kosovës edhe Partitë Politike të sillen si të tilla për të respektuar rendin dhe ligjin në mënyrë që të kemi një shtet funksional dhe një gjendje të qetë në raport të sigurisë.

Raporti është nga Drejtori i Policisë, e kemi kërkuar për shqyrtim por mendoj që ka nevojë për rekomandime që do të jenë në bazë të vlerësimeve dhe vërejtjeve që u dhanë në mënyrë që Policia e Kosovës kur të ofroj raport ta ofroj me të dhëna të sakta dhe me përgjegjësi të plotë në mënyrë që imazhi i Policisë së Kosovës të jetë i mirë dhe vlerësimet nga ana e Komisionit të jenë përmbajtjesore de nuk do donim që të kishim Raporte të pa dëshiruara që flasin për shtetin ose qytetarët e Kosovës.

Ne si Komision të drejtën për të kërkuar Raporte e kemi për ato Institucione që i mbikëqyrin si, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e FSK_së, Policia e Kosovës dhe nga mekanizmat e sigurisë, për të tjerat janë të dhëna mediave, të parive të lëvizjeve ose organizmave të tjerë, por ne bazoheni në raportet që na vijnë nga mekanizmat që ne i monitorojmë dhe këtyre Raporteve duhet tu referohemi më shumë.

Në bazë të vërejtjeve që u dhanë këtu, do të krijojmë një dokument me rekomandime që do ti drejtohet Policisë së Kosovës që të përmirësohet gjendja për aq sa është e mundur në Raportim dhe në ngritjen e imazhit të Policisë së Kosovës.

Konkluzionet dhe rekomandime nga mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikqyrjen e FSK-së për raportin e PK-së për ngjarjet e 14 Janarit

Komisioni në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2012 pasi ka shqyrtuar raportin e PK-së për ngjarjet e 14 Janarit 2012 ka nxjerr këto konkluzione dhe rekomandime.

- Raporti i dorëzuar në Komision nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së është raport i bazuar në rrjedhat e protestës së 14 Janarit dhe përmban të dhëna për veprimet policore sipas planit operativ të përpiluar paraprakisht.

- Përpos raportit policorë, Komisioni ka edhe informacione të ndryshme lidhur me rrjedhjen e ngjarjeve.
- Janë identifikuar disa raste individuale ku ka dyshim të bazuar për tejkalim autorizimesh nga ana e PK-së.
- Këto raste individuale qoftë nga pjesëtarë apo eprorë të PK-së për asnjë çast nuk duhet të zbehin imazhin e Policisë së Kosovës karshi qytetarëve të vendit.
- Deri javën e kaluar 4 raste janë hapur për hetim; Tri raste janë dërguar në Drejtorinë për Standarde Profesionale pranë PK-së dhe një rast është duke u hetuar nga Inspektorati Policorë i Kosovës. Rastet tjera ende janë në hetim preliminar (grumbullim dhe analizim të provave).

Rekomandime:

- Raporti i PK-së duhet të plotësohet me të dhëna të sakta statistikore të cilat duhet të përfshijnë:
 1. Numrin dhe natyrën e lëndimeve të pjesëtarëve të PK-së dhe protestuesve.
 2. Arrestimin e Deputeteve të Parlamentit të Kosovës
 3. Arsyetimin për ndërhyrje në pronat private
 4. Lëndimi i gazetarëve
 5. Numrin e rasteve nën hetim lidhur me ngjarjet e 14 Janarit
- Organet përgjegjëse; Inspektorati Policorë i Kosovës po ashtu edhe Drejtoria për Standarde Profesionale pranë PK-së sa më shpejt të jetë ë mundur të përmbyllin dhe të publikojnë rezultatet e hetimeve.
- Pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë nevojë për trajnime shtesë për menaxhimin e turmave dhe pajisje shtesë për situata të tilla.
- Pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë nevojë të përmirësojnë nivelin e komunikimit përmes pajisjeve teknike pasi që ka pasur pengesa teknike në komunikim në mes njësiteve përkatëse.

Pas nxjerrjes së këtyre rekomandimeve Kryetari vazhdoi me pikën e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Për këtë projektligj udhëheqës i grupit punues ka qenë z. Anton Quni, fjalën ia kaloj që të sqaroj punën e bërë.

Anton Quni- Ligji nuk ka qenë shumë voluminoz, kërkesa e Ministrisë që mos të interferojmë aq shumë në përcaktimin e përqindjeve të pensionit fillestar që lidhet me vitin e shërbimeve dhe pensionet invalidore. Ne ju kemi përmbajtur kërkesës së tyre, ndërhyrja jonë është më shumë në çështje teknike, gjuhësore dhe Projektligji është i gatshëm të paraqitet para deputetëve të Kuvendit.

Fatmir Xhelili- Amendamentet e propozuara do të shërbejnë që ligji të jetë cilësor dhe për plotësimin e kriterëve për pensionimin e pjesëtarëve edhe të ish-TMK-së edhe të FSK-së si dhe dinamikën e parë për pensionimin e tyre. Besoj që ky ligj do të jetë i zbatueshëm dhe për këtë është siguruar edhe buxheti.

Rexhep Selimi- Mbështes rekomandimet dhe raportin për Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Pyeti anëtarët e Komisionit se a pajtohen për ta proceduar Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Seancë me rekomandime? Ky propozim u miratua pa kundërshtime.

5. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-89 për dominim humanitar;

Kryetari i Komisionit- Edhe për këtë Projektligj z. Anton Qunit ka qenë udhëheqës i grupit punues, fjalën ia kalojmë për të shpjeguar punën e bërë.

Anton Quni- Me këtë ligj krijohet një Qendër koordinuese e deminimit në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës e cila do të ketë të gjitha autorizimet që të gjitha organizatat që merren me këtë fushëveprimtari nëpërmjet kësaj Qendre ti marrin lejet, autorizimet apo puna e tyre të anulohet apo suspendohet në bazë të performancës. Tani ekziston një bazë ligjore ku kjo fushë është e mbuluar edhe me ligj. Projektligji është në nivel dhe do të jetë funksional.

Fatmir Xhelili- Përkrasi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara dhe se kjo fushë rregullohet mirë me këtë ligj dhe bëhet adresimi i saktë i kompetencave për dominim humanitar.

Rexhep Selimi- Përkras raportin me Rekomandime.

Kryetari i Komisionit- Bazuar në përvojën e TMK-së, FSK-së është krijuar dhe ligji dhe pajtohemi që bashkë me Rekomandimet ky Projektligj të shkojë në seancë. Të gjithë anëtarët e Komisionit votuan pro këtyre rekomandimeve.

6. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Pyeti të pranishmit se a kanë diçka për të shtuar në këtë pikë?

Rexhep Selimi- Kërkoj që, duke qenë se nga mbledhja e herës së kaluar e datës 25 janar 2012, Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës shprehu gatishmërinë që të bëjë një Raport për Komisionin. Komisioni mund të kërkojë këtij institucioni me shkrim një Raport se a kanë konstatuar shkelje që duhet të hetohen.

Kryetari i Komisionit- Nga Inspektorati Policor jemi njoftuar me shkrim që janë katër(4) raste nën hetim, për këtë arsye po i japim pak kohë e nëse pas kësaj kohe nuk kemi Raport mund ta kërkojmë.

Fatmir Xhelili- Raporti nga Inspektorati Policor kërkon kohë pasi ka informacione të shumta që duhet të analizohen, prandaj duhet ti japim kohë.

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë do të kemi prezantimin e një Organizate të quajtur IRID, prezent do të jetë përfaqësuesi i organizatës i cili do të bëjë prezantimin e ideve të tyre. Ky është një Komision i ngjashëm me Ombudspersonin i cili në shtete të tjera është i rregulluar me ligj dhe që në realitet mbron vetëm të drejtat e forcave të armatosura, civile(policisë) apo ushtarake. Ky institucion ekziston në shumicën e vendeve Evropiane që janë edhe pjesë e NATO-s.

Në vende të ndryshme ky Komision i përgjigjet drejtpërdrejtë parlamentit dhe është Institucion i pavarur.

Kërkesa e kësaj organizate është drejtuar Komisionit Parlamentar për ta mbështetur me një letër interesim në mënyrë që të filloj shqyrtimi për themelimin e këtij institucioni. Komisioni Parlamentar për Siguri dhe Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk do të ngarkohet me implikime buxhetore gjatë aktiviteteve që do të kryhen nga ky institucion.

Në rast të shprehjes së gatishmërisë për vazhdimin tutje nga organizata IRID do të bëjë prezantimin e projektit me të gjitha detajet dhe shembujt konkret për themelimin e këtij Institucioni.

Prezantimi i ideve për këtë Projekt u bë nga drejtuesit e Projektit.

Derek Shields- Prezantoi Institutin për Zhvillim dhe Inovacion, duke shpjeguar që i njohin rrethanat dhe situatat në Kosovë, shprehi gatishmërinë për ofrimin e ndihmës teknike ose çfarëdo qoftë ajo.

Shpend Qamili- Pas studimeve të shumta kemi ardhur në konstatimin se në Kosovë mungon një institucion i tillë, si Institucion i pavarur i cili do të shërbente si shkallë e dytë e ankesës për forcat e armatosura. Modeli gjerman mund të shërbej edhe për Kosovën i cili është treguar shumë funksional.

Burimet financiare për këtë Institucion do të vijnë nga jashtë dhe nuk do të ngarkojnë buxhetin e Kosovës. Nëse e shihni të nevojshme dhe të arsyeshme një mbështetje të tillë, do të përgatisim projektin me të gjitha pikat bashkë me stafin e Komisionit dhe më pas do të paraqitet për tu shqyrtuar në Komision.

Rexhep Selimi- E konsideroi një Institut të tillë të nevojshëm pasi shpeshherë ndodh që forcat e armatosura të kenë vështirësi në realizimin e drejtave të tyre, por përshtatjen e një modeli të Kosovës për këtë Institut do të ishte modeli i duhur.

Kryetari i Komisionit- Kam dy pyetje. Baza ligjore e një Institucioni të tillë cila do të jetë?

Fatmir Xhelili- Pyeti prezantuesit e projektit, se sa staf është i nevojshëm për këtë Institut dhe cilat janë kalkulimet buxhetore, pasi pas një kohe ju do të vazhdoni të financoheni nga buxheti i Kosovës apo si do të rregullohet kjo?

Çfarë mekanizmi përdor ky Institut që të hetoj raste të caktuara?

Në Kodin e procedurës Penale janë të përcaktuar mekanizmat që kanë të drejtë hetuesisë.

Forca e Sigurisë së Kosovës është ndërtuar në bazë të standardeve të NATO-s, Gjermania ka kontribuar për ndërtimin e FSK-së, por nuk është përmendur një mekanizëm i tillë pasi forcat e armatosura e kanë Inspektoratin për çështje disiplinore. Kosova ka zyrat e autorizuar që mbrojnë të drejtat e forcave të armatosura. Kuvendi i Kosovës ka funksion mbikëqyrës përmes mekanizmit të Komisionit për Siguri ndaj segmenteve që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Shpend Qamili- Baza ligjore për krijimin e këtij mekanizmi është Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila lejon krijimin e mekanizmave mbikëqyrës të pavarur për këtë çështje.

Mekanizmi Hetimor edhe pse është një çështje e ndjeshme, Instituti parasheh hetime jo të llojit klasik por një lloj mbikëqyrje. Me këtë mekanizëm, nëse Instituti krijohet atëherë Komisionari është ai i cili do të ketë qasje në ato informacione që konsiderohen sekrete nga institucionet e sigurisë, duke realizuar një lloj hetimi.

Inspektorati si mekanizëm mbikëqyrës dhe kontrollues është shkallë bazë për ankesa ndërsa Komisionari do të ishte shkallë shtesë dhe e pavarur e ankesave. Mungesa e institucioneve civile

mbikëqyrëse për Institucionet e Sigurisë përmendet edhe në Raportin e Progresit për vitin 2011. Elaborim më të gjerë mund të bëjmë edhe më shkrim brenda një jave.

Afrim Ademi- Projekti do të bëhet me të gjitha detajet për këtë çështje, kjo instancë u referohet të drejtave dhe lirive të personave që kanë armë, prandaj krijimi i një mekanizmi të tillë do të shpejtonte edhe zgjidhjen e lëndëve që kanë mbetur përgjysmë për rastet e personave pjesëtarë të Institucioneve të Sigurisë.

Anton Quni- Sa do të ketë forcë ekzekutive ky Institucion?

Shpendi Qamili- Ekzistojnë disa modele se si funksionon, do të ofrojmë disa modele dhe u si Komision të ofroni opinionet që mendoni se është modeli më i mirë.

Kryetari i Komisionit- Kërkojmë nga ju që të paraqisni një projekt dhe pastaj si Komision bëjmë vlerësimin e tij dhe më pas do të analizojmë informacionet e ofruara nga ana juaj dhe si Komision do të kemi vlerësimin për këtë çështje. Me këtë pikë të Rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:35

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi